VENDIM
Nr. 915, datë 11.11.2015

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI, NGA KËSHILLAT E QARQEVE TE BASHKITË, TË RRJETIT TË RRUGËVE RURALE DHE TË ASETEVE TË LUAJTSHME E TË PALUAJTSHME TË NDËRMARRJEVE TË MIRËMBAJTJES SË KËTYRE RRUGËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "c", të pikës 3, të nenit 10, të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", të ndryshuar, dhe të neneve 3, shkronja"f", e 5, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit te njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rrjeti i rrugëve rurale, i cili është administruar nga këshillat e qarqeve, në bazë të vendimit nr. 667, datë 15.12.2000, të Këshillit të Ministrave, t'i kalojë në pronësi bashkive, sipas tabelës 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Transferimin në pronësi, nga ndërmarrjet e mirëmbajtjes së rrugëve rurale, aktualisht në varësi të këshillave të qarqeve, te bashkitë, të:

a) aseteve të paluajtshme të këtyre ndërmarrjeve te bashkitë në territorin e të cilave është vendndodhja e tyre, sipas tabelës 2 bashkë-lidhur këtij vendimi;

b) mjeteve motorike, sipas tabelës 3 bashkë-lidhur këtij vendimi;

c) mjeteve e pajisjeve të këtyre ndërmarrjeve, në përputhje me shkronjën "a", të kësaj pike.

3. Transferimi të kryhet nën mbikëqyrjen e prefektit të qarkut.

4. Ngarkohen bashkitë për të kryer evidentimin e inventarit të rrugëve rurale dhe komunale, si dhe në bashkëpunim me Institutin e Transportit, të përditësojnë këtë rrjet rrugor në hartën dixhitale, duke iu referuar hartave bashkëlidhur këtij vendimi, brenda datës 31 dhjetor 2015. Harta dixhitale e përditësuar publikohet në Gjeoportalin Kombëtar që administrohet nga ASIG-u.

5. Autoriteti Rrugor Shqiptar rakordon inventarin e rrugëve në administrim të tij me atë në pronësi të bashkive dhe paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave projektvendimin për saktësimin e klasifikimit e të ndarjes së rrjetit rrugor midis këtij autoriteti dhe bashkive, brenda datës 31 dhjetor 2015.

6. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, ndërmarrjet e mirëmbajtjes së rrugëve rurale, në varësi të këshillave të qarqeve, shkrihen. Kryetari i qarkut, brenda pesë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, merr masa për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për punonjësit e këtyre ndërmarrjeve, duke respektuar afatet, procedurat dhe mënyrat e përcaktuara në Kodin e Punës. Efekti financiar për largimin e punonjësve përballohet nga buxheti i këshillave të qarqeve.

7. Transferimi i inventarit të rrugëve dhe aseteve të ndërmarrjeve sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi, nga këshillat e qarqeve te bashkitë, të shoqërohet me transferimin edhe të financave përkatëse te bashkitë, duke filluar nga viti 2016.

8. Vendimi nr. 667, datë 15.12.2000, i Këshillit të Ministrave, "Për kalimin e rrugëve rurale në administrimin e këshillave të qarqeve", shfuqizohet.

9. Ngarkohen ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, Ministria e Financave, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Instituti i Transportit, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia për Zbatimin e Reformës Territoriale, prefektët e qarqeve, ASIG, këshillat e qarqeve dhe bashkitë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama